

VENDIM
Nr. 29, datë 16.1.2003

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË “UZINA MEKANIKE”, SHPK, PATOS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqëria “Uzina Mekanike”, shpk, Patos t’i nënshtrohet procesit të privatizimit. Forma e privatizimit të shoqërisë të jetë transferimi i së drejtës së pronësisë së pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të saj të tretëve.

2. Struktura e formulës së privatizimit, për transferimin e së drejtës së pronësisë së pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të saj të tretëve.

a) Struktura e formulës së privatizimit, për transferimin e së drejtës së pronësisë së pjesëve të barabarta të kapitalit të shoqërisë, të jetë si më poshtë vijon:

b) Ish-pronarëve të truallit t’u afrohen pjesë të barabarta të kapitalit, përlogaritur sipas vlerës së këtij trualli, të përfshirë në kapitalin themeltar të shoqërisë, në mbështetje të akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi.

c) Punonjësve të shoqërisë t’u afrohen pjesë të barabarta të kapitalit në shkëmbim të vlerës së bonove të privatizimit, dhënë atyre nga shteti. Madhësia e kësaj pakete nuk mund të jetë më e madhe se 20 për qind e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Punonjës të “Uzinës Mekanike”, shpk, Patos, quhen punonjësit efektivë në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe punonjësit e kësaj shoqërie, të dalë në asistencë me vendimet nr.422, datë 9.7.1998, e nr.372, datë 27.5.2001, të Këshillit të Ministrave.

3. Procedurat e privatizimit të shoqërisë të bëhen në mbështetje të vendimit nr.119, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”.

4. Formula e privatizimit të pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të shoqërisë të përcaktohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano